

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Jellena Krivokapiq, kryetare, Emine Kaçiku dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në lëndën kontestimore të paditësit G F nga ..., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, të cilën me autorizim e përfaqëson Naim Rexha, me bazë juridike kompenzim i diferencës në pagë, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 1171/17 datë 06.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.05.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr.1171/17 datë 06.12.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1171/17 dt.06.12.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2430/14 dt.01.07.2016, me të cilin është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr. ..., dt..., gjithashtu është detyruar e paditura që paditësit t'ia kthej koeficientin 6 dhe t'ia paguaj ndryshimin e pagës në shumë prej 88.63 € për çdo muaj, prej 01.02.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 6 dhe 5, për çdo muaj + 10% si dhe zvogëlimin e kontributeve në trust në lartësinë 4,43 € duke filluar nga data 01.12.2012 e në muajt në vazhdim, të gjitha këto me kamatën vjetore ligjore siç e paguajnë bankat për mjetet pa destonacion të caktuar, të afatizuara 12 muaj duke filluar nga data 05/09.2012 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe të anulohen të dy aktgjykimët, ndërsa çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të revizionit, në kuptim të nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Revizioni është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë pune për kohë të pacaktuar sipas cilës paditësit i janë përcaktuar detyrat e punës në pozitën Anëtar i ekipit në qendrën e thirrjeve, njësia 'Vala', Prishtinë, si dhe i është caktuar paga bazë për punën të gradës 6. Me vendimin e të paditurës (me shprehjen e njëanshme të vullnetit të saj) nr... dt..., paditësit i është caktuar grada 5, nga data 01.02.2012 e tutje. Ky vendim sipas të paditurës konsiderohet si pjesë përbërëse e kontratës së punës. Paditësi në afatin e paraparë prej 8 ditësh ka paraqitur ankesë, por nuk ka marrë përgjigje. Konsideron se me uljen e të ardhurave personale nga grada 6 në gradën 5 është bërë shkelja e dispozitave ligjore, e në bazë të shkresës së datës 06.10.2011 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar bordit të drejtorëve të të paditurës sipas së cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme për vitin 2012 duhet të jetë jo më shumë se 20%.

Në një gjendje të tillë të çështjes, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ç'rast e ka anuluar aktvendimin e të paditurës dhe e ka detyruar që paditësit t'ia paguaj ndryshimin e pagës në mes të gradës 6 dhe 5, në shumë prej 88,63 €, për çdo muaj, prej datës 01.12.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, ndryshimin e bonusit dhe trustit, në mes gradës 6 dhe 5 për çdo muaj 10%, si dhe zvogëlimin e kontributeve në trust në lartësinë 4.43 €, duke filluar nga data 01.12.2012 e në muajt në vazhdim, të gjitha këto me kamatën vjetore ligjore siç e paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuara për 12 muaj, duke filluar nga data 05.09.2014 e deri në pagesën e plotë, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Pasi që gjykata vërtetoi se degradimi i të ardhurave personale nga grada 6 në gradën 5 është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të neneve 10.1, 2.11, 55.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, përkatësisht me nenin 5 të kontratës së punës, kjo Gjykatë vlerësoi se është parimi i së drejtës se palët me vullnetin e tyre të lirë të shprehur mund të ndryshojnë apo të shuajnë një marrëdhënie juridike, e jo vetëm me shprehjen e njëanshme të vullnetit të saj. Gjykata e Apelit duke shqyrtuar

pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit gjeti se gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen e vërtetuar faktike drejt kanë aplikuar dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), dhe nuk ka pasur aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Neni 182.2 (n) LPK parashikon se shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo nëse në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit. Pra, aktgjykimi nuk ka të meta për shkak të cilave nuk ka mundur të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe nuk ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit.

Janë të pabazuar pretendimet e të paditurës se gjykata e shkallës së dytë me rastin e nxjerrjes se aktgjykimit të kontestuar, ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1 lidhur me nenin 190, përkatësisht 191 të LPK-së, ngase e njëjta gjykatë nuk ka hapur shqyrtim dhe nuk i ka thirrur palët, meqenëse e njëjta gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe për këtë arsye është konsideruar si e panevojshme që të thirren palët.

Sa i përket pretendimit e të paditurës lidhur me afatshmërinë e padisë duke u thirrur në nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar pasi që në rastin konkret është dashur të aplikohet dispozita e nenit 87 të këtij ligji, ku përcaktohet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë konkluduar se paditësja kishte drejtë në pagë të përcaktuar në kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe në aktin e brendshëm të punëdhënësit. Është paraparë së paditësit i është caktuar paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të

gradës 6. Kërkesa, shkresa apo ndonjë akt tjetër nga ministria nuk paraqet bazë juridike për uljen e pagës, përkatësisht të gradës, ngase e njëjta është caktuar me kontratë. Për këtë arsye, e paditura është e detyruar që paditësit t'ia paguajë ndryshimin në të ardhurat personale mujore për periudhën e lartpërmendur. Lartësia e diferencës së pagës është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në bazë të listës së pagave, për muajt janar, shkurt dhe maj 2012. Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimet e lartcekura nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të së drejtës materiale.

Pretendimi se paditësi është njoftuar dhe është pajtuar për kushtet e kontratave të reja të punës nr... dt.22.12.2015, ..., dt.02.02.2016, nga kjo Gjykatë nuk është shqyrtuar, meqenëse revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike (neni 214.2 i LPK-së), ndërsa neni 216 i LPK parashikon se palët mund të parashitrojnë me revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë. E paditura këtë fakt ka mundur të paraqes në gjykatën e shkallës së parë.

Poashtu, sa i përket pretendimit e të paditurës lidhur me rastet e njëjta ose të ngjashme, dhe vendimet e ndryshme të marra nga gjykata e shkallës së dytë, kjo Gjykatë thekson se çdo vendim i Gjykatës së Apelit i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të veçantë të revizionit, dhe në atë rast Gjykata Supreme për të eliminuar dallimet e lartpërmendura, merr vendim unanim.

Për arsyet e paraqitura më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 220 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.47/2018 datë 23.05.2018.

Kryetare e kolegjit,
Jellena Krivokapiq

Përktheu: Ferid Abazi